

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Infrastrukturë TIK për AKPT”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP)

Paketa software për back-up ose rekuperim 48710000-8, Paketa software dhe sisteme informacioni 48000000-8

VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 1,338,750 (një milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme."

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më**

pak se 19% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë për Serverin, Storage NAS dhe Storage për Backup, katalog/skedë teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit. Në katalogët / skedat teknike të paraqitura, duhet të markohen specifikimet teknike sipas DST. Nëse katalogu/ët /skeda teknike janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / broshurave / skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Ky kriter është vendosur për të mundësuar verifikimin e plotë dhe objektiv të karakteristikave teknike të pajisjeve të ofertuara. Duke qënë se objekti i prokurimit përfshin Server, Storage NAS dhe Storage për Backup, të cilat janë pjesë të rëndësishme të infrastrukturës TIK, është e nevojshme të provohet se pajisjet e propozuara përmbushin parametrat minimalë të përcaktuar në specifikimet teknike. Paraqitja e katalogëve ose skedave teknike të prodhuesit siguron një burim zyrtar dhe të verifikueshëm për kontrollin e këtyre parametrave, ndërsa markimi i specifikimeve përkatëse lehtëson identifikimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë së ofertës me kërkesat e DST-së. Katalogu/skeda teknike do të shërbejnë gjithashtu

edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.3 Operatori ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit duhet të disponojë të paktën 1 (një) specialist IT, me kualifikim dhe/ose eksperiencë në instalimin dhe konfigurimin e serverave, storage, sistemeve backup ose infrastrukturave të ngjashme TIK. Specialisti do të angazhohet në instalimin, konfigurimin dhe migrimin e të dhënave.

a. Operatori ekonomik në lidhje me specialistin e kërkuar duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Kontratë pune të vlefshme ose kontratë bashkëpunimi;
- CV
- Çertifikatë/Diplomë/Dëshmi kualifikimi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

Shënim* Kriteri Nr.2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të nenit të 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimi 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” dhe Urdhërit nr.99, datë 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Specialisti i sipërpërmendur kërkohet në përputhje të plotë me objektin e prokurimit. Ky kriter është vendosur pasi objekti i prokurimit nuk përfshin vetëm furnizimin e pajisjeve, por edhe instalimin, konfigurimin dhe vënien e tyre në funksion në infrastrukturën ekzistuese të Institucionit. Gjithashtu, realizimi i kontratës kërkon ndërhyrje në server, storage dhe sistemet e backup-it, si dhe kryerjen e procesit të migrimit të të dhënave. Për këtë arsye, disponimi i të paktën 1 (një) specialisti IT me kualifikim dhe/ose eksperiencë në këto fusha është i nevojshëm për të garantuar realizimin korrekt të proceseve teknike dhe funksionimin normal të infrastrukturës pas implementimit. Lidhur me kërkesën që specialisti i IT jo domosdoshmërisht kërkohet të jetë staf i qëndrueshëm i ofertuesit të mundshëm ekonomik por mund të kontraktohet nga operatorët ekonomikë të interesuar për realizimin e objektit të prokurimit. Ky përcaktim në këtë mënyrë është bërë duke mbajtur parasysh parimet dhe vetë qëllimin e ligjit të prokurimit sikundër janë nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë sigurimi i një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; si edhe sigurimi i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës së punës ose kontratës së bashkëpunimit, CV-së dhe dokumentacionit të kualifikimit është vendosur për të vërtetuar se specialisti i deklaruar është realisht në dispozicion të operatorit

ekonomik dhe zotëron kualifikimin e nevojshëm për realizimin e detyrave teknike të parashikuara. Duke qenë se specialisti do të angazhohet në instalimin, konfigurimin dhe migrimin e të dhënave, dokumentacioni i kërkuar mundëson verifikimin e kapacitetit profesional të tij dhe krijon siguri se operatori ekonomik disponon burimet njerëzore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent** (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar me mall cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001:2015 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e afatit të garancisë për pajisjet objekt prokurimi sipas afateve të përcaktuara në specifikimet teknike. Garancia duhet të jetë minimumi 3 (tre) vjet për Serverin dhe minimumi 1 (një) vit për Storage NAS dhe Storage për Backup. duke nisur nga data e lëvrimit të tyre dhe gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve që vijnë për shkak të prodhimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm të pajisjeve gjatë periudhës së përdorimit dhe mbulimin e defekteve që mund të shfaqen për shkak të prodhimit. Duke qenë se Serveri, Storage NAS dhe Storage për Backup do të përdoren për funksionimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave të Institucionit, është e rëndësishme që pajisjet të kenë mbulim të përshtatshëm garancie. Afati minimal prej 3 (tre) vjetësh për Serverin dhe 1 (një) viti për Storage NAS dhe Storage për Backup synon të sigurojë mbështetjen e nevojshme teknike dhe riparimin e defekteve gjatë periudhës së përcaktuar.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se pajisjet e ofertuara Server, Storage NAS dhe Storage për Backup duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe jo të rinovuara.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur për të garantuar që pajisjet që do të furnizohen në kuadër të kësaj procedure të jenë të reja dhe të mos kenë qenë më parë në përdorim apo të jenë pajisje të rinovuara/refurbished. Duke qenë se pajisjet Server dhe Storage do të përdoren si pjesë e infrastrukturës TIK të Institucionit dhe do të mbajnë e përpunojnë të dhëna, kërkohet që ato të ofrojnë jetëgjatësi, performancë dhe besueshmëri të plotë. Furnizimi me pajisje të reja ul gjithashtu riskun e defekteve të parakohshme dhe siguron përdorimin e plotë të ciklit të tyre të jetës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se bateritë e ofertuara duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe kompatibël me UPS-in SPS POL 3RM 3000VA (3kVA). Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër instalimin dhe testimin e tyre në pajisjen ekzistuese.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur për të garantuar që bateritë e furnizuara të jenë të përshtatshme dhe plotësisht kompatibël me UPS-in ekzistues SPS POL 3RM 3000VA (3kVA). UPS-i ka rol të rëndësishëm në sigurimin e vazhdimësisë së furnizimit me energji dhe mbrojtjen e pajisjeve TIK nga ndërprerjet ose luhatjet e energjisë elektrike, ndaj përdorimi i baterive të përshtatshme është i domosdoshëm për funksionimin korrekt të tij. Kërkesa për instalimin dhe testimin nga operatori ekonomik synon gjithashtu të sigurojë vendosjen e saktë të baterive dhe verifikimin e funksionimit normal të UPS-it pas zëvendësimit.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë si më poshtë vijon;

I. Aneksi II – Specifikimet Teknike

1. Server

Karakteristika Minimale Teknike

SERVER	1 copë
Modeli	Të jetë model për Rack
Procesori	1 x Procesor, min 8 cores me min. 18000 pike sipas benchmark të publikuar në http://www.cpubenchmark.net
Memorja RAM	Të ketë të përfshirë min. 64 GB, DDR4, ECC
Kapaciteti	2 x 480GB SSD
Storage Controller	Të jetë i dedikuar dhe të suportojë RAID 0/1/1+0/5

Kartë Rrjeti	Min. 2 x 1 Gigabit Ethernet (RJ45)
Porta	Të ketë min. 1 VGA dhe min. 2 porta USB
Sistem Ushqimi	Redundant Hot Plug Power Supplies
Manaxhimi	Të suportoje 1 porte LAN të dedikuar për menaxhim
Sistemi Operativ	Të suportoje: Microsoft Windows Server 2019, 2022, Microsoft Hyper V 2019, 2022, RHEL, SLES etj.
Garancia	Min 3 vjet garanci

Serveri i furnizuar do të instalohet, konfigurohet dhe integrohet me infrastrukturën aktuale. Pasi të kryhen testimet pajisja dhe të pranohet nga stafi përgjegjës i Institucionit.

2. Storage NAS

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	Min 1,500 Pikë
“Chipset”:	Min Intel ose Ekuivalent
Memorie	Min 2 GB
Vende per HDD	Min 4 Vende
Kompatibiliteti I HDD	3.5 "SATA HDD, 2.5" SATA HDD, 2.5 "SATA SSD.
Kapaciteti i zgjerueshëm, deri në	Min 72 TB
Kapaciteti i përfshirë	Min 40 TB
HDD Hot Swapp	Po
Portat Eksternale	RJ-45 2.5 GbE LAN Port x 4, USB 3.0 port x 2, USB 3.2 port x 2.
Zgjatuesit PCI	1 x Gen3 x8 slot (black, x4 link).
GARANCIA NORMALE	min 1 Vit

Storage i furnizuar do të instalohet, konfigurohet dhe integrohet me infrastrukturën aktuale. Pasi të kryhen testimet pajisja dhe të pranohet nga stafi përgjegjës i Institucionit.

3. Storage për backup

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	Min 1,500 Pikë
“Chipset”:	Min Intel ose Ekuivalent
Memorie	Min 2 GB
Vende per HDD	Min 4 Vende
Kompatibiliteti I HDD	3.5 "SATA HDD, 2.5" SATA HDD, 2.5 "SATA SSD.
Kapaciteti i zgjerueshëm, deri në	Min 72 TB
Kapaciteti i përfshirë	Min 40 TB
HDD Hot Swapp	Po

Portat Eksternale	RJ-45 2.5 GbE LAN Port x 4, USB 3.0 port x 2, USB 3.2 port x 2.
Zgjatuesit PCI	1 x Gen3 x8 slot (black, x4 link).
GARANCIA NORMALE	min 1 Vit

Storage i furnizuar do të instalohet, konfigurohet dhe integrohet me infrastrukturën aktuale. Pasi të kryhen testimet pajisja dhe të pranohet nga stafi përgjegjës i Institucionit.

4. Software për backup

Numri i instancave 5 (pesë) instanca

Software duhet të plotësojë kërkesat minimale teknike si më tej vijon:

- Mundësi backup në nivel makine virtuale dhe fizike. Mundësi backup inkremental të përhershëm, pa pasur nevojë për backup-e të plotë periodik. Deduplikim dhe kompresim të përfshirë.
- Mundësi për ruajtjen dhe rikthimin e të dhënave në nivel imazhi, gjë që optimizon transferimin e të dhënave
- Mundësi replikimi të makinave virtuale. Mundësi replikimi direkt nga backup-et e makinave virtuale.
- Mundësi testimi i backup-eve të makinave virtuale dhe replikimin e tyre përpara se t'i riktheje ato në punë
- Rikthim i makinave virtuale në host-in origjinal ose në host tjetër. Mundësi për të ngritur shërbimet shpejt duke ngritur makinën virtuale direkt nga backup. Mundësi recovery në nivel file.
- Manaxhim të centralizuar për platforma të ndryshme (makina fizike dhe virtuale).
- Suport për Vmware dhe Hyper-V. Konsolë menaxhimi e instalueshme më vete nga server i backup.
- Software të ofrohet me mbështetje 1 (një) vjeçare nga prodhuesi.

Software do të instalohet, konfigurohet në infrastrukturën që do i vihet në dispozicion nga Institucioni. Pasi të kryhen testimet software dhe të pranohet nga stafi përgjegjës i Institucionit.

5. Bateri për UPS-it SPS POL 3RM, me kapacitet 3000VA (3kVA), 8 copë **(8 x 12VDC).**
kompatibël me UPS-in.

Bateritë e furnizuara do të instalohen, konfigurohen dhe integrohen me pajisjen UPS. Pasi të kryhen testimet komponentët bateri, dhe të pranohen nga stafi përgjegjës i Institucionit.

6. Shërbimin e migrimit të të dhënave që ndodhen në hdd-në aktive të serverit që disponon Institucioni Server Dell EMC PowerEdge R440 në serverin e ri që do furnizohet.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga autoriteti kontraktor përfitues për objektin që prokurohet sipas nevojës, duke përcaktuar informacionin minimal të nevojshëm, në përputhje

me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik. Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) disponon aktualisht pajisje informatike dhe pajisje të tjera teknike të cilat përdoren për realizimin e detyrave të përditshme në fushën e planifikimit analizës dhe hartimit të dokumenteve të territorit. Pajisjet ekzistuese megjithëse funksionale kanë performancë të kufizuar për përpunimin e të dhënave me volum të madh dhe me rezolucion të lartë. AKPT në veprimtarinë e saj përdor programe të specializuara si: QGIS, ArcGIS, ArcGIS online, AutoCAD, paketa Adobe dhe aplikacione të tjera përpunimi hapësirë të mjaftueshme ruajtjeje dhe mbështetje grafike të avancuar për të garantuar një mbarëvajtje optimale të punës të cilat do të përpunojnë dhe të dhënat live në “Share folder” i cili do të jetë në disa prej pajisjet e sipërpërmendura. Për të siguruar vazhdimësinë e proceseve dhe për t’ë shmangur ndërprerjet e punës për shkak të kufizimeve teknike është e domosdoshme që infrastruktura ekzistuese të plotësohet me pajisje të reja dhe të përmirësuara.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor përfitues. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT: